

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm** (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushitri), e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditësit:

dhe që të nga Mitrovica të cilët i përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Av. nga Mitrovica, kundër të paditurit: të cilin e përfaqëson Përfaqësuesi i Përkohshëm Av. baza e kontestit: Vërtetim Pronësie, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 05.06.2013 me prezencën e të gjitha palëve, me datën 11.06.2013 bie këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. VËRTETOHET** se paditësit: dhe që të nga Mitrovica janë bashkëpronarë me nga 1/4 mbi bazën e shitblerjes gojore dhe mbajtjes në parcelën kadastrale Nr. P- /Mitrovicë, në sipërfaqe të tërësishme prej 66 m2.

**II. OBLIGOHET** i padituri që ta pranojë dhe t'ia lejojë paditësve që paluajtshmërisë e cekur në piken **I** të dispozitivit, të rexhistrohen si bashkëpronarë të kësaj paluajtshmërie, në të kundërtën ky atgjykim të njëjtëve do të ju shërbejë si titull ekzekutiv për rexhistrim

**III. OBLIGOHET** paditësi që në emër të shpenzimeve gjyqësore për përpilimin e aktgjykimit t'ia paguajë gjykatës shumën prej 20 euro në afat 15 ditor pas plotfuqishmërisë së të njëjtit nën kërcënim të ekzekutimi të detyrueshëm.

## **A r s y e t i m**

Paditësit me anë të padisë, ka kërkuar që të vërtetohet se janë pronar të paluajtshmerisë e cila evidentohet në Fletën poseduese nr.UL-ZK/Mitrovicë në sipërfaqe prej 66m2 ha, që udhëhiqet në emër të të paditurit, nga baza e shitblerjes.

Në fjalën përfundimtari, përfaqësuesi i paditëses Av. deklaron: Mbetem në tërësi pran padis dhe kërkesëpadinë, kërkoj nga gjykata që të vërtetohet se paditësit dhe

janë bashkëpronarë të paluajshmërisë P-  
sipërfaqe prej 66m2. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

ne

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: Padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses e kundërshtoj, mirëpo provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk i kundërshtoi, ndërsa ia le gjykatës që në bazë të provave të vendos. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata në procedurën provuese administroi këto prova: Certifikata e vdekjes së \_\_\_\_\_ e dt.13.07.2005 bashkëshorti i ndjerë i paditëses, Certifikata e martesës e \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ e dt.01.10.1982, Certifikata e lindjes \_\_\_\_\_, Certifikata e lindjes \_\_\_\_\_, Certifikata e lindjes \_\_\_\_\_, Vërtetimi lëshuar nga Ujësjiellësi Rajonal i dt.26.02.2009, Ekstrakti i ish Elektro-Kosova i vitit 1981, Ekstrakti nga Ujësjiellësi i viteve 1991-1994, Dëshmi e vdekjes për të ndjerin \_\_\_\_\_ i dt.13.01.2009, \_\_\_\_\_, Certifikata mbi të drejtën e pronës me nr. UL- \_\_\_\_\_ e dt. 26.01.2009.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, dhe pas vlerësimeve arriti në këto përfundime:

Nuk është kontestuese që paditësit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ janë shfrytëzuesë dhe posedues të papenguar i paluajtshmerisë-parcelës kadastrale P- \_\_\_\_\_ ne sipërfaqe 66m2.

Nuk është kontestuese fakti që paditësja e parë është bashkëshortja ndërsa paditësit e tjerë janë fëmijët e tani të ndjerit \_\_\_\_\_, pasi që një gjë të tillë vërtetohet përmes certifikatave të lindjes së fëmijëve dhe asaj të martesës.

Nuk është kontestuese fakti që i ndjeri \_\_\_\_\_ paluajtshmerinë kontestuese e ka blere në vitin 1979, në vlerë prej 55.000,00 dinar të atëhershëm nga i padituri \_\_\_\_\_ por të cilën shitblerje e ka bërë me marrëveshje gojore.

Nuk është kontestuese se paditësja me anëtarët e familjes së vet menjëherë pas blerjes ka hyrë në posedim dhe të njëjtën e shfrytëzon pa ndërprerë si dhe rregullisht i ka kryer obligimet e pagesës së Ujësjiellësit Regional, faturat e energjisë elektrike si dhe obligimet tjera, kjo vërtetohet në bazë të vërtetimit të Ujësjiellësit Rajonal dhe nga faturat e KEK-ut me të cilat paditësja është ngarkuar rregullisht.

Pikërisht duke u bazuar në këto fatura të përmendura gjykata vërteton bazueshmërinë e kërkespadiisë rreth mirëbesimit, kohëzgjatjes së posedimit të paluajtshëmirsë që është objekt kontesti.

Prandaj, gjykata nga provat e cekura me larte si dhe gjendjen e vertetuar faktike si dhe nga faketet jokontestuese, konstatoi se paditesve dhe në bazë te nenit 40 te Ligjit per Pronesine dhe të drejtat tjera sendore i aplikueshëm qe nga viti 2009, Ligji nr.03/L-154 neni 40 e ka parapar fitimin e pronsis me mirëbesim nese kan kaluar 20 vjet në posedim të pandërprer.

Gjykata lidhur me vendosjen mbi shpenzimet procedurale, u bazua ne nenin 450 te LPK-se, ngase pasi qe paditësi nuk i kërkoj shpenzimet e procedurës, prandaj vlerësoj qe secila pale duhet bartur shpenzimet e veta te shkaktuara me veprimet e tyre ndërsa për shpenzimet gjyqësore u bazua ne nenin 10.12 ne lidhje me nenin 10.1 te Udhëzimit Administrativ të KGJK-se për unifikim te Taksave Gjyqësore nr. 2008/2.

Andaj, gjykata konform nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,  
C.nr. 96/2009 me dt. 11.06.2013**

**GJYQTARI,  
Faton Ademi**

**UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.